



AMBIENTI
KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE

KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR. 247
DATA 15.01.2026

Në mbështetje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes duke u bazuar në nevojën e brendshme për organizim më efikas të punës, Kryeshefi Ekzekutiv nxjerr këtë:

VENDIM

I. Rishqyrtohet statusi i klientëve të evidentuar si jo-rezidentë, të cilët aktualisht faturohen me tarifën e reduktuar prej 1 (një) euro për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.

II. Klientët e cekur në pikën I të këtij dispozitivi obligohen që, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e njoftimit në faqen zyrtare të kompanisë, të paraqesin dëshmi zyrtare nga KEDS/KESCO, e cila vërteton mos-konsumimin e energjisë elektrike në shtëpinë përkatëse.

III. Në rast se klienti nuk paraqet dëshminë e kërkuar brenda afatit të përcaktuar sipas pikës II të këtij dispozitivi, i njëjti humb të drejtën e trajtimit me tarifë të reduktuar dhe i aplikohet tarifa e rregullt prej 6 (gjashtë) euro, sipas tarifës për amvisëri.

IV. Zbatimi i tarifës së rregullt sipas pikës III të këtij dispozitivi do të fillojë nga muaji pasues (janar), pas përfundimit të afatit për paraqitjen e dëshmisë.

V. Për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij vendimi ngarkohen njësitë përkatëse organizative për faturim të ndërmarrjes.

Kryeshefi Ekzekutiv
Diedon Berisha



Pejë me Data: 15.01.2026